



KOSOVA / KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo			
Ministria e Ekonomisë dhe Financave / Ministarstvo Privrede i Finansije			
Ministry of Economy and Finance			
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo			
Prishtinë / Pristina			
Nivelo Org Org. Level	29	D. Dred Dist. No	09/1556
Nr. Fajese Projshanca No. pages	—	Data Datum Date	05/08/2009
Prishtinë/A			

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCEVE – MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE – MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE  
**ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS – PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA – TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO**

Me qëllim të bashkëpunimit dhe mbështetjen ndërinstitucionale që ka të bëjë me regjistrimin dhe çregjistrimin e tatimpaguesve, Administrata Tatimore e Kosovës, të cilën e përfaqëson z. Behxhet Haliti – Drejtor i përgjithshëm, (në tekstin e mëtejshëm: **ATK**) nga njëra ane dhe Agjencioni për Regjistrimin e Biznesit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, të cilën e përfaqëson Mehdi Pllashniku – Ushtues detyre i Drejtorit të Agjencionit (në tekstin e mëtejshëm: **ARBK**) nga ana tjetër, me datën: **5 Gusht 2009** lidhin këtë:

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI  
NDËRMJET  
ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS  
dhe  
AGJENCIONIT PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është sigurimi i zbatimit të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-071 i cili ka ndryshuar dhe plotësuar Ligjin Nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Neni 7 i Ligjit Nr. 03/L-071 obligon ATK-në që të pajis me numër fiskal çdo tatimpagues rezident dhe jo-rezident si dhe njoftimi i bizneseve për obligimin e tyre për pajisje me numra fiskal .

**Neni 2  
Bashkëpunimi**

- 2.1. Bashkëpunimi ndërmjet ATK-së dhe ARBK, është i domosdoshëm për arsye se të gjitha bizneset që veprojnë në Kosovë e janë të regjistruara në ARBK duhet të pajisen me numër fiskal pran ATK-se.
- 2.2. Bashkëpunimi i ndërsjellët do të ndihmonte ATK-në në procesin e regjistrimit dhe pajisjes me numra fiskal. Me këtë memorandum do të bëhet shkëmbimi i materialeve të nevojshme ndërmjet ATK-së dhe ARBK-së.

### Neni 3

- 3.1. ARBK-ja pajtohet që me rastin e dorëzimit të certifikatës për biznesin e regjistruar – pronarit apo përfaqësuesit (pranuesit të certifikatës) së bashku me certifikatën t'i dorëzon njoftimin dhe aplikacionin me të cilën njoftohet biznesi për pajisje me numër fiskal pran ATK-së.
- 3.2. ATK-ja merr për obligim që të pajisë ARBK-në me kopje fizike të mjaftueshme të njoftimit dhe aplikacionit të cilët do t'iu dorëzohen palëve sikurse në pikën 3.1. të këtij Memorandumi.

### Neni 4

#### Publikimi i bizneseve jo aktive dhe atyre që riaktivizohen

- 4.1. Nëse nga ATK ndonjë Tatimpagues vendoset në regjistrin jo aktivë, ATK do të njoftojë ARBK-në për atë veprime dhe arsyet për marrjen e atij veprimi si dhe do të ofroj të gjitha të dhënat e biznesit.
- 4.2. Në rast se i njëjti tatimpagues jo aktiv më vonë fillon të ushtroj aktivitet ekonomik, ATK do të njoftoj ARBK-në se ky tatimpagues është kthyer në regjistrin e bizneseve aktive, duke ia ofruar të gjitha informatat e biznesit dhe arsyet e aktivizimit.

### Neni 5

#### Bërja publike për mos pajisje me numër fiskalë


Administrata Tatimore e Kosovës do të bëjë publik emrat e bizneseve që nuk ju është lëshuar numri fiskalë për shkak të historisë jo të mirë dhe mos përmbushjes së detyrimeve tatimore, si dhe do të njoftohet ARBK për mos pajisje, duke i ofruar informatat e biznesit dhe arsyet për marrjen e një vendimi të tillë.


### Neni 6

#### Hyrja në fuqi

Ky memorandum i mirëkuptimit hynë në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dy palët dhe do të aplikohet deri sa nuk tërhiqet asnjëra palë nënshkruese e këtij memorandumit me njoftim paraprak.

Prishtinë, datë: 05.08.2009

Behxhet Haliti  
  
Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së

Mehdi Pllashniku  
  
UD i Kryeshefit Ekzekutiv  
të ARBK-së